



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 198/5 prot.

Tiranë më 5.04.2019

REKOMANDIM

Nr. 26, datë 5.04.2019

PËR KONTROLLUESIN "DREJTORIA E PËRGJITHSHME E GJENDJES
CIVILE"

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 pika 1/ "a/1" dhe 32 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "*Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile*",

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr.31 datë 05.02.2019 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetimi administrativ pranë kontrolluesit "*Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile*", me objekt:

- Verifikimi i lajmeve të publikuara në media lidhur me publikimin e Regjistrit të Gjendjes Civile dhe aksesin e pakufizuar në të dhënat personale të shtetasve shqiptarë. Verifikimi i masave të marra nga kontrolluesi "*Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile*" në kuadër të garantimit të sigurisë dhe konfidencialitetit të të dhënave personale të përpunuara nëpërmjet Regjistrit të Gjendjes Civile, në zbatim të ligjit nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, dhe akteve nënligjore të miratuara nga Komisioneri.

Paraprakisht, Zyra e Komisionerit ndërmori hapa për të verifikuar specifikat e faqes së internetit që ka bërë publikimin dhe teknikave të përdorura për publikimin e bazës së të dhënave, duke konstatuar se baza e të dhënave personale të shtetasve shqiptarë është ngarkuar fillimisht në Google Drive dhe është publikuar në faqen online të krijuar në platformën pa pagesë të Google (www.blogspot.com) në datën 09.01.2018 dhe është edituar për herë të fundit në datën 08.03.2018.

Zyra e Komisionerit, me qëllim shmangien e pasojave të mëtejshme nga publikimi dhe përhapja e paligjshme e të dhënave personale të shtetasve shqiptarë në kundërshtim me ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, i është drejtuar Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) duke kërkuar bashkëpunimin për marrjen e masave për raportimin dhe bllokimin e faqes së internetit ku është publikuar baza e të dhënave, në linkun <http://gjendjacivile.blogspot.com/2017/12/shkarko-gjendjen-civile-2008-microsoft.html>. Me shkresën nr. 198/3 Prot, datë 14.02.2019, AKEP e ka informuar Zyrën e Komisionerit se ka kërkuar nga çdo operator/sipërmarrës që ofron shërbime të komunikimeve elektronike, të ndërmarrin masa për bllokimin e kësaj faqeje web.

Inspektimi pranë këtij kontrolluesi ka filluar kryesisht nga Zyra e Komisionerit, në zbatim të nenit 31/1/e të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, duke vlerësuar rëndësinë dhe seriozitetin e përpunimit të të dhënave personale në këtë fushë, sasinë e madhe të të dhënave personale të publikuara dhe në referim të artikujve të publikuar në media lidhur me përhapjen e paligjshme të të dhënave të “Regjistrimit të Gjendjes Civile”.

Veprimtaria e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, në kuadër të administrimit të Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile, rregullohet në bazë të ligjit nr. 10129 datë 11.05.2009 “Për Gjendjen Civile”, të ndryshuar, VKM-së Nr.365 datë 11.06.2004 “Për krijimin dhe mënyrën e mbajtjes së Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile dhe për rregullat e shfrytëzimit të teknikës dhe rrjetit informatik” dhe Udhëzimit të përbashkët nr. 95 datë 07.04.2014 “Për përcaktimin e institucioneve dhe organeve që marrin të dhëna personale nga shërbimi i gjendjes civile, si dhe mënyrën, llojin dhe sasinë e informacionit që duhet të marrin”, të miratuar nga Ministri i Brendshëm dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

1. Zyra e Komisionerit gjatë ushtrimit të hetimit administrativ konstatoi se nga analizimi i përmbajtjes së bazës së të dhënave të publikuar në linkun <http://gjendjacivile.blogspot.com/2017/12/shkarko-gjendjen-civile-2008-microsoft.html>, rezultojnë se kategoritë e të dhënave personale të publikuara (*emri, mbiemri, atësia, amësia, datëlindja, vendlindja, seksi, gjendja civile, emri dhe mbiemri i bashkëshortit, kombësia, të dhënat e trungut familjar, adresa dhe numri i banesës*), korrespondojnë me të dhënat që përpunon kontrolluesi Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile. Kjo bazë të dhënash përmban 4.220.323 regjistrime (profile subjektsh të të dhënave) dhe regjistrimi më i fundit i korrespondon datës 31.12.2008.

Në këtë kuadër, Zyra e Komisionerit krijon bindjen e arsyeshme se të dhënat personale të publikuara kanë si burim të tyre të dhënat e administruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe/ose Zyrat Vendore të Gjendjes Civile.

2. Zyra e Komisionerit, bazuar edhe në informacionin e siguruar nga përfaqësuesit e kontrolluesit, konstatoi se përpara krijimit të sistemit qendror të Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile, Zyrat e gjendjes Civile kanë funksionuar nëpërmjet bazave të të dhënave lokale. Këto baza lokale u përgatitën nga procesi i hedhjes së të dhënave nga regjistrat themeltarë të regjistrimit të popullsisë të vitit 1974 dhe në vazhdim nga vetë nëpunësit e gjendjes civile, janë mbledhur dhe ngarkuar në një bazë të dhënash qendrore, e cila ka

shërbyer si pikënisje për krijimin e sistemit qendror të Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile në vitin 2010. Të dhënat e aplikimit lokal janë përdorur nga nëpunësit e gjendjes civile, si mjet ndihmës për procedura të ndryshme, si pastrimi i dublimeve, gjetja e adresave nëpërmjet regjistrave themeltar, verifikim dhe kontroll për saktësinë e të dhënave nga baza lokale në bazën qendrore (RKGJC), etj. Të dhënat e shpërndara lokalisht në zyrat e Gjendjeve Civile kanë qenë në bazë të dhënash të siguruara me mbrojtje sipas procedurës elektronike (autentikim, enkriptim) megjithatë, kontrolluesi nuk siguroi informacion lidhur me faktin se çfarë kishte ndodhur me databazën/aplikimin e përdorur deri në vitin 2008 pas vënies në funksionim të sistemit qendror të Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile.

Në këtë kuadër, Zyra e Komisionerit vlerëson se me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale të shtetasve shqiptarë, kontrolluesi duhet të kishte marrë masa për shkatërrimin e bazave lokale të të dhënave personale me qëllim shmangien e aksesit dhe përhapjes së paligjshme të tyre.

3. Pas publikimit në media të lajmit lidhur me publikimin e bazës së të dhënave të gjendjes civile, për kontrolluesin lind detyrimi që të reagojë dhe të marrë masa konkrete për shmangien e pasojave. Por në këtë rast, Zyra e Komisionerit konstatoi se kontrolluesi nuk ka marrë masa konkrete për shmangien e përhapjes së paligjshme të të dhënave personale të shtetasve shqiptarë nëpërmjet publikimit të linkut, në kuadër të detyrimit për garantimin e sigurisë dhe konfidencialitetit të të dhënave personale të përpunuara gjatë administrimit të Regjistrimit të Gjendjes Civile.

Gjithashtu, kontrolluesi nuk ka hartuar një Rregullore të Brendshme lidhur me masat e sigurisë fizike dhe teknike në kuadër të përpunimit të të dhënave personale nëpërmjet Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile dhe proceseve të tjera përpunuese që kryhen gjatë ushtrimit të aktivitetit, në kundërshtim me nenin 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar.

Zyra e Komisionerit e vlerëson si mjaft të rëndësishëm hartimin e rregullores për mbrojtjen e të dhënave personale, pasi përbën bazën e referimit për çdo përpunim të të dhënave, për çdo punonjës, dhe përcakton standardet ligjore për garantimin e një përpunimi të ligjshëm dhe të sigurtë të të dhënave personale të qytetarëve. Rregullorja duhet të jetë gjithëpërfshirëse (të përfshijë çdo lloj përpunimi të të dhënave personale për çdo kategori subjektsh të të dhënave).

Lidhur me konstatimet e Zyrës së Komisionerit evidentuar në procesverbalin e hetimit administrativ (datë 07.03.2019), përfaqësuesit e kontrolluesit kanë shprehur rezerva dhe kanë depozituar pretendimet përkatëse në formë elektronike, të cilat janë administruar në dosjen e hetimit administrativ për vlerësim nga ana e Zyrës së Komisionerit.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 27, 29, 30, 31 pika 1/ "a/1" dhe 32 pika 1 të Ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi “Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile”, në zbatim të nenit 27 të ligjit nr. 9887/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, ka detyrimin:
 - Të hartojë dhe miratojë një Rregullore të Brendshme lidhur me masat e sigurisë fizike dhe teknike në kuadër të përpunimit të të dhënave personale nëpërmjet Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile dhe proceseve të tjera përpunuese që kryhen gjatë ushtrimit të aktivitetit, deklaruar edhe në formularin e njoftimit;
 - Të verifikojë pranë çdo Zyre Vendore të Gjendjes Civile ekzistencën e bazave lokale të të dhënave, përdorur para krijimit të sistemit qendror të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile, dhe të realizojë fshirjen përfundimtare të tyre në mënyrë të pakthyeshme;
 - Të marrë masa dhe të ndërmarrë veprime të menjëhershme, duke bashkëpunuar edhe me institucione të tjera shtetërore apo aktorë të tjerë, lidhur me bllokimin ose fshirjen e faqes së internetit nëpërmjet të cilës janë bërë publike të dhënat personale të shtetasve shqiptarë sipas formatit të regjistrit të gjendjes civile;
2. Kontrolluesi “Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile”, të kryejë të gjitha detyrimet që burojnë nga ligji dhe nga ky akt, brenda një afati 45 ditor nga momenti i marrjes dijeni dhe të njoftojë me shkrim Zyrën e Komisionerit për masat e marra. Përbushja e këtyre detyrimeve nga kontrolluesi, përbën objekt kontrolli të vazhdueshëm nga Zyra e Komisionerit.
3. Në rast mos përbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të ligjit nr. 9887/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të Rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 5.04.2019.

KOMISIONERI
Besnik Dervishi

